

LIGJ
Nr.7691, datë 18.3.1993

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7503, DATË 26.7.1991 "PËR STATUSIN E
DEPUTETIT TË KUVENDIT POPULLOR", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7563, DATË
11.5.1992**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Paragrafi i dytë i nenit 13 të ligjit nr.7563, datë 11.5.1992 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7503, datë 26.7.1991 "Për statusin e deputetit të Kuvendit Popullor", ndryshohet si vijon:

"Shpenzimet për bisedat e tij telefonike deri në 400 impulse në muaj, përballohen nga shteti".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.510, datë 7.4.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.